



## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH. II.974/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të propozuesit të masës së sigurimit Lunari Company shpk, me seli në fshatin Komogllavë Komuna e Ferizajit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Jeton Berisha avokat nga Ferizaj, kundër të paditurve/kundërshtarve të masës së sigurimit B.L. nga fshati Doganaj, Kaçanik, dhe NTP Binaku Trans me seli në fshatin Gaçkë Ferizaj, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit Herolind Kryeziu avokat nga Lipjani, duke vendosur lidhur me ankesën e kundërshtarve të sigurimit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhoma e shkallës së parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.5/24 datës 21.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 13.05.2024, mori këtë:

### A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kundërshtarve të masës së sigurimit B.L. nga Kaçaniku dhe NTP Binaku Trans nga Ferizaj, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.5/24 i datës 21.03.2024, VËRTETOHET

### A R S Y E T I M

Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KE.nr.5/24 i datës 21.03.2024, ka vendosur si në vijim: I Aprovohet si i bazuar propozimi i propozuesit të masës së sigurimit Lunari Company shpk, dhe i Ndalohet kundërshtarve të sigurimit B.L. nga Kaçaniku dhe NTP Binaku Trans nga Ferizaj, që ta tjetërsojnë-shesin, apo ndërmarrin qfardo veprimi, të mos e përdorin-shfrytëzojnë, të përmbahen nga çfarëdo veprimi që mund ta demolojë apo asgjesojë, apo të marr qfardo veprimi juridik dhe faktik që do të ndryshonte gjendjen juridike dhe faktike të kamionit të markës Daimler-Benz me numer shasisë .... me numer targave ....., deri në vendosjen me vendim të formës së prerë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i kundërshtarve të masës së sigurimit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, me propozimin që të Aprovohet si e bazuar ankesa, të ndryshohet Aktvendimi i atakuar ashtu që të refuzohet propozimi i propozuesit të masës së sigurimit për caktimin e masës së sigurimit si të pabazuar ose lënda të kthehet në rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 194 e lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa pathemelt

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesi i sigurimit Lunari Company shpk, nga Ferizaj, përmes të autorizuarit të tij, me datën 25.01.2023, pranë gjykatës ka ushtruar padi me propozimin për caktimin e masës së sigurisë ndaj të paditurve/kundërshtarve të masës së sigurimit B.L. nga Kaqaniku dhe NP Binaku Trans nga Ferizaj, duke arsyetuar se paditësi ka blerë kamionin me marveshje nga të paditurit dhe iu ka bart mjetet e çmimit kontraktues përmes llogaris bankare të paditurit të dytë sipas marveshjes, ndërsa të paditurit për arsye të panjohura nuk kanë ndërmarr veprime për bartjen e pronësisë së kamionit në posedim faktik të paditësit, andaj ka kërkuar nga gjykata caktimin e masës së sigurimit ndaj kundërshtarve të sigurimit dhe t,iu ndalohej ta tjetërsojnë-shesin që të disponojnë apo ndërmarrin qfardo veprimi me qëllim përfitimi në përdorim, të mos e përdorin-shfrytëzojnë, apo të ndërmarrin qfardo veprimi juriidk që do të ndryshonte gjendjen juridike dhe faktike të kamionit i markës Daimler-benz nr.shasisë ....., me tabela ....., deri në marjen e vendim të fomës së prerë.

Dhoma e shkallës së parë lidhur me propozimin e masës së sigurimit, ka mbajtur seancën dëgjimore me datën 15.03.2024, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe ka marrë Aktvendimin e atakuar KP.nr.5/24 datës 21.03.2024, me të cilin ka Aprovuar si të bazuar propozimin e propozuesit të masës së sigurimit Lunari Company shpk, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

Në arsyetim të këtij vendimi, dhoma e shkallës së parë, ka dhënë shpjegimet ligjore nga neni 297 të LPK-së, dhe vendimin e ka mbështet në provat e lëndës, respektivisht faturës nr.05/2020 dt.21.07.2020 e lëshuar nga kundërshtari i dytë i sigurimit NP Binaku Trans nga Ferizaj, për propozuesin dhe urdhërpagesa nr.DF/ËF-013101320873 me të cilën është kryer pagesa nga propozuesi. Në arsyetim më tej theksohet se gjykata vleron se ekziston rreziku që pa caktimin e masës së sigurisë do të vështirsohej realizimi i kërkesës përmes tjetërsimit të pasurisë apo dëmtimit të njëjtit, me të cilat do të ndryshonte gjendja ekzistuese e gjërave.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Dhomës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave kontestimore sikurse pretendohet në ankes, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i vleroi në baza ligjore ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të kundërshtarve të sigurimit, dhe të njëjtën nuk e vleroi si të bazuar për ta ndryshuar një gjendje tjetër të konstatuar nga dhoma e shkallës së parë. Kolegji vleroi se në rastin konkret Dhoma e

shkallës së parë, me të drejt ka aplikuar nenin 297 të LPK-së, se në rastin konkret kundërshtarët e sigurimit edhe pse kanë pranuar pagesën për mallin-kamionin e kontraktuar sipas faturës nr.05/2020 të cilën e ka lëshuar vet i padituri i dytë NTP Binaku Trans nga Ferizaj, për propozuesin e masës së sigurimit, nuk kanë dhënë asnjë arsye të bazuar pse nuk kanë bartur në posedim faktik dhe bartjen e këtij kamioni në pronësi të propozuesit të masës së sigurimit si pronar juridik. Andaj bazuar në këto fakte, edhe Kolegji vlerëson se propozuesi i masës së sigurimit e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës respektivisht të drejtës subjektive të tij dhe ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë propozuesit do t'i shkaktohej dëm i konsiderueshëm i cili vështirë do të mund të riparohet. Dhoma e shkallës së parë në arsyetimin e aktvendimit, drejtë ka vlerësuar se pa caktimin e masës së këtillë, palët kundërshtarë do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së propozuesit.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të kundërshtarve të sigurimit se nuk është arsyetuar kushti ligjor për caktimin e masës së sigurisë, duke u bazuar në supozime dhe aktvendimi i atakuar është i paqartë dhe në kundërshtim me dispozitat procedurale, i përfshire me shkelje nga neni 182 par.2 pika (n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Kolegjit të Dhomës së Shkallës së Dytë, këto pretendime nuk janë të bazuara, ngase në këtë rast masa siguroese e caktuar nga dhoma e shkallës së parë, është arsyetuar mjaftueshëm si mjet për parandalimin e ndryshimit të gjendjes ekzistuese të objektit kontestues, nga palët kundërshtarë, të cilat propozuesit mund t'ia pamundësojnë apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës. Kolegji vlerësoi se dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Përfundimisht, Dhoma e Shkallës së Dytë e ka pranuar vlerësimin dhe përfundimin e dhomës së shkallës së parë, pasi që i ka vlerësuar vetëm rrethanat dhe veprimet nga të cilat gjykata mund të nxjerrë besueshmërinë e kërkesës apo të drejtës subjektive, si dhe ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së tillë propozuesit të sigurimit, do të mund të shkaktohej dëm i riparueshëm.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, Dhomat e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 194, 208 dhe nenit 209 pika (b) të LPK-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.974/24 i datës 13.05.2024

Kryetari i Kolegjit – gjyqtari  
Krenar Berisha